

V E N D I M
“NE EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Sabri Rrapi,	Anëtar i “ “
Zija Vuci,	Anëtar i “ “
Hajredin Fuga,	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço,	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi,	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi,	Anëtar i “ “
Kujtim Puto,	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, më datën 17.10.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.65 Akti që i përket:

KËRKUES: AVOKAT SPIRO KASSO

O B J E K T I

Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.138, datë 26.11.1999 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.93, datë 24.03.2000 të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi në kërkesë dhe në seancë gjyqësore ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve të mësipërme:

1. Vendimet bien ndesh me parimet e Kushtetutës dhe me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale për të drejtat e mbrojtësit në gjykimin penal. Mbrojtësi i të pandehurit të gjykuar në mungesë gëzon të gjitha të drejtat, pra edhe të drejtën e ankimit;

2. Avokati ka qenë pajisur me prokurë të posaçme nga familjarët e të pandehurit për të bërë ankim dhe kjo ka vlerë juridike njëloj me prokurën e të pandehurit;

3. Gjykata e Apelit dhe kolegji penal i Gjykatës së Lartë, nuk kanë vlerësuar as prokurën e lëshuar nga vetë i pandehuri pas ankimit të bërë nga avokati e para gjykimit në Gjykatën e Apelit. Me këtë prokurë, ai miraton ankimin e bërë nga avokati.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi shpjegimet e kërkuesit, administroi provat dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Gjykata e Rrethit Fier, me vendimin nr.197, datë 04.10.1999 ka deklaruar fajtor të pandehurin Klodian Rrushi për veprën penale të parashikuar nga nenet 76-23, 278/2 dhe 323/1-50/gj të Kodit Penal dhe duke bërë bashkimin e krimeve e ka dënuar me 8 (tetë) vjet burgim. I pandehuri është gjykuar në mungesë dhe është mbrojtur nga avokati Kujtim Sina. Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr.138, datë 26.11.1999, ka vendosur mospranimin e ankimit të paraqitur nga avokati Spiro Kasso, me arsyetimin se kur u paraqit në gjykatë ankimi, nuk ka qenë i pajisur me aktpërfaqësimi të lëshuar në formën e parashikuar nga ligji, pra me prokurë të lëshuar nga vetë i pandehuri. Këtë vendim e ka lënë në fuqi kolegji penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.93, datë 24.03.2000.

Avokati Spiro Kasso, ka bërë ankim brenda afatit ligjor kundër vendimit të dënimit të Gjykatës së Rrethit Fier. Për këtë, ai ka qenë i pajisur me prokurë të lëshuar nga i ati i të pandehurit. Prokura e familjarëve të të pandehurit të gjykuar në mungesë, është një aktpërfaqësimi i vlefshëm për ankim në kuptim të nenit 410/2 të Kodit të Procedurës Penale. Ajo është lëshuar në formën e parashikuar nga ligji, sepse neni 48 i Kodit të Procedurës Penale, lejon që zgjedhja e mbrojtësit për personin e dënuar me burgim, të bëhet edhe nga një i afërm i tij me akt të dhënë mbrojtësit. Duke mos i pranuar ankimin, Gjykata e Apelit Vlorë dhe kolegji penal i Gjykatës së Lartë, kanë cënuar të drejtën

themelore të mbrojtjes dhe të ankimit të parashikuara nga nenet 31 e 43 të Kushtetutës dhe njëkohësisht kanë zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, sepse i pandehuri nuk ka realizuar dot as të drejtën e ankimit dhe as atë të mbrojtjes. Ky qëndrim, vjen në kundërshtim gjithashtu edhe me kërkesat e nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, me nenin 2/1 të Protokollit nr.7 të kësaj konvente dhe nenin 14/5 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

Përsa sipër dhe duke rikonfirmuar qëndrimin tonë mbajtur në vendimet nr.17, datë 07.04.2000 e nr.48, datë 28.07.2000, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë dhe vendimi i kolegjit penal të Gjykatës së Lartë, duhet të shfuqizohen si antikushtetues.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f e 134/g të Kushtetutës si dhe të neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I

Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.138, datë 26.11.1999 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.93, datë 24.03.2000 të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë.

Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Vlorë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 08.11.2000
Nr.65 i Regj.Themeltar.
Nr.77 i Vendimit.

MENDIMI I PAKICES

Jemi kundër vendimit të shumicës që ka shfuqizuar si antikushtetues vendimet nr.138, datë 26.11.1999 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.93, datë 24.03.2000 të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë, për këto arsye:

Kërkesa në Gjykatën Kushtetuese është paraqitur nga avokati Spiro Kasso. Sipas neneve 28 gërma “e” dhe 29 gërma “a” të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, kërkesa në Gjykatën Kushtetuese paraqitet me nënshkrimin e kërkuarit ose të përfaqësuesit të tij. Në rastin konkret, i dënuari nuk e ka nënshkruar vetë kërkesën dhe as që ka caktuar përfaqësues me-akt përfaqësimi. Kështu, përderisa kërkesës nuk i është bashkëlidhur akti i përfaqësimit, sipas gërmës “a” të nenit 29 të ligjit të sipërcituar, avokati Spiro Kasso nuk mund të vejë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Rregullat e mësipërme i ka vendosur vetë ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, prandaj nuk mund të zbatohen rregulla të tjera që vijnë ndesh me këtë ligj. Kjo është një nga arsyet që kërkesa nuk duhej pranuar.

Gjithashtu, në vështrim të dispozitave procedurale penale, vendimi i shumicës, sipas mendimit tonë, në themel nuk është i drejtë, sepse sipas nenit 50 të Kodit të Procedurës Penale, ankimi është një e drejtë që i rezervohet vetëm të pandehurit dhe për rrjedhojë, pa pëlqim të tij të dhënë në formën e parashikuar në ligj, nuk ka të drejtë të ushtrojë ankim të afërmit ose persona të autorizuar prej tyre. Për më tepër, neni 410 paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Penale thekson se për gjykimin në mungesë, mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i pajisur me një akt përfaqësimi të lëshuar në formën e parashikuar nga ligji. Sikurse rezulton nga dosja, i pandehuri nëpërmjet një prokure të hartuar në Gjirokastrë ka autorizuar avokatin që ta përfaqësojë në Gjykatën e Apelit. Kjo do të thotë që i pandehuri i ka pasur mundësitë të caktojë përfaqësues për t’u përfaqësuar në të gjitha instancat gjyqësore, ashtu edhe për t’u përfaqësuar në Gjykatën Kushtetuese.

Mosrespektimi i këtyre normave ligjore si përsa i përket paraqitjes së kërkesë në Gjykatën

Kushtetuese ashtu edhe për përfaqësimin në instancat ligjore, e bëjnë vendimin e shumicës të pambështetur në ligj.

ANËTARË
K. Puto, H. Fuga